



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

## PROCESVERBAL

### Nga mbledhja e V-të e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 28.05.2014

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Ali Januzi, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Ismet Gashi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani, dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Arta Ismajli, anëtare e kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –propozoi që në rend dite në “të ndryshme” të futen këto pika:

- a. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë shëndetësore për shërim.
- b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – duke iu referuar vërshimeve të fundit nga të reshurat, propozoi që kuvendi i komunës të bëjë kërkesë tek organet më të larta shtetërore për t’u formuar fondi për sigurimin e të mbjellave në bujqësi. Pastaj tha se çështje e rëndësishme që duhet të përfundojë është legalizimi i objekteve të ndërtruara pa leje, në rastet ku mund të legalizohen, duke parandaluar ndërtimet pa leje në të ardhmen. Po ashtu ngriti çështjen e kompleksit banesor “Kalaja”, duke shtuar se banorët aktual kanë investuar privatisht në meremetimin e apartamenteve të kompleksit banesor në fjalë, prandaj kërkesa e këtyre banorëve është reale, sepse edhe AKP-ja ka kërkuar që komuna t’ua dërgojë një shkresë mbështetëse për t’ua aprovuar investimet e bëra nga banorët aktual, përmes vlerësimit real nga ana e ekspertëve.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –propozoi që në rend dite në “të ndryshme” të futet edhe shqyrtimi i kërkesës së banorëve të lagjes së kompleksit banesor “Kalaja”.**

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime miratoi këtë:**

#### **REND DITE**

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Draft-Statutit për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (shqyrtimi i dytë).
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.
4. Shqyrtimi i Propozimeve për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve (DKRS).
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet dhe parandalimet e ndërtimeve pa leje ndërtimore, si dhe masat e ndërmarra për pranimet teknike të objekteve shumëkatëshe në Komunën e Vushtrrisë (Drejtoria për Inspektime).
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë (Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim).
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore të komunës (Drejtoria për Buxhet dhe Financa).
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e vendimit të Kuvendit të komunës 01.Nr.23/14 i datës 30.01.2014.
9. Shqyrtimi i draft-rregulloreve:
  - a) Për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat fillore të Komunës së Vushtrrisë.
  - b) Për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat e mesme të ulëta të Komunës së Vushtrrisë.
  - c) Për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.
11. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien e ndihmës financiare për shërim.
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve.
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi për transfere dhe subvencione.
14. Të ndryshme:
  - a. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë shëndetësore për shërim.
  - b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).
  - c. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të lagjes të kompleksit banesor “Kalaja”.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

**Ergin Sunguri-** tha se në diskutimin e tij nuk janë përmendur turqit nga Holanda, të cilët kanë investuar në shkollën fillore në fshatin Ceceli.

**Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, me vërejtjen e E.Sungurit.**

## **2. Shqyrtimi i Draft-Statutit për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (shqyrtimi i dytë).**

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-** pyeti drejtorin e DSHPS-së për çfarë arsye draft-statutit në fjalë nuk iu është bashkëngjitur materiali shtesë lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna gjatë diskutimit publik.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-statutit në fjalë, paraqiti këto vërejtje dhe propozime: te neni 4.2 tha se është dashtë të jetë pjesë e këtij neni edhe shenja njohëse e QKMF-së; te neni 19.3 kërkoi që të përmendet pozita e zëvendës-drejtorit; te neni 21.2 pika "b" në vend të fjalisë "neni 15 pika 7", duhet të jetë" neni 16 pika 7"; te neni 33.1 propozoi që akronimi DSHPS të zëvendësohet me termin Drejtoria Komunale për Shëndetësi, duke propozuar që kjo drejtori të mos ketë kompetenca tjera përveç shëndetësisë, duke kërkuar që i njëjti emërtim të figurojë edhe te neni 33.4.

**Idriz Muzaqi, përgjegjës i Zyrës Ligjore-** lidhur me draft-statutin në fjalë, propozoi që te neni 2 të hiqet fjalia "QKMF-ja ka statusin e personit juridik publik", pasi që QKMF-ja nuk e ka statusin e personit juridik. Pastaj në nenin 6.4 dhe në çdo vend tjetër në draft-statutin në fjalë ku thuhet "gjuhët në përdorim zyrtar në Kosovë" të zëvendësohet me fjalinë "në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës".

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** tha se nuk pajtohet me mosrespektimin e procedurave ligjore, të cilat janë të përcaktuara, ku çdo akt i përgjithshëm që procedohet për kuvend, së pari duhet të kalojë përmes Zyrës Ligjore të Komunës, pastaj në Zyrën për Integritet Evropiane.

**Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së-** paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-statutin në fjalë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet Statuti i Qendrës së Mjekësisë Kryesore Familjare, duke inkorporuar vërejtjet dhe propozimet e anëtarëve të kuvendit dhe të zyrtarit ligjor.***

## **3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.**

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, te neni 5 fjalia "i propozon komunës për dhënien në shfrytëzim të tokës ndërtimore..." të riformulohet me sa vijon "i propozon kuvendit", pasi që kuvendi është autoritet që e jep në shfrytëzim. Te neni 6 kërkoi që të precizohet se çka po ndryshohet.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Jepet për diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.***

***Diskutimi publik fillon nga data 29.05.2014 dhe zgjat deri më 17.06.2014.***

## **4. Shqyrtimi i Propozimeve për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve.**

**Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës-** paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozimet në fjalë. Po ashtu propozoi për mirënjohje Fahredin Gynlerin, kontribuues i madh i çështjes kombëtare shqiptare.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-** kërkoi që për secilin propozim të lexohet biografia e tyre.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** propozoi që Qazim Ukës t'i ndahet titulli "Nderi i qytetit", pasi që ka kontribuar dhe sakrifikuar shumë për çështjen e Kosovës.

Pastaj për sukseset e arritura në futboll, propozoi që t'i ndahet mirënjohje klubit të futbollit "Kosova Llamkos", trajnerit të këtij klubi dhe tifozëve "Forca".

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit-** në emër të Grupit të grave asambleiste, propozoi për mirënjohje dy veprimtare të dalluara: Myrvete Pantinën dhe Gjylsime Fekën.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** - propozoi për mirënjohje Behar Dushin, përfaqësues për Vushtrri, i Organizatës "Human Appeal International", për kontributin e dhënë në hapjen e puseve në objektet shkollore.

**Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit-** propozoi për mirënjohje doktor Blerim Fekën, pasi që ka ndihmuar shumë Shoqatën e Martirëve, duke bërë kontrollime mjekësore falas për anëtarët e kësaj shoqate.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit-** propozoi që Aziz Biciti t'i ndahet titulli "Nderi i qytetit", i cili ka qenë një ndër komandantët më të shquar të UÇK-së, si dhe ka qenë nënkryetar i Komunës së Vushtrrisë.

**Syzana Sylja, anëtare e kuvendit-** propozoi për mirënjohje veteranen e arsimit Zehra Maxhunin.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota "për", të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:**

**Me këtë vendim, për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 qershor 2014, nderohen me Titullin "Nderi i qytetit" siç vijon:**

**Safet (Haki) Ajeti – dëshmor i kombit, në shenjë respekti për kontributin e madh në çlirimin e Kosovës, i cili ra në altarin e lirisë më 14.06.1999 në Begunc-Viti.**

**Ilaz Kolla (post mortum).**

**Aziz Bici, për rezultatet në luftë si komandant i shquar i UÇK-së.**

**Qazim Uka.**

**Me mirënjohje nderohen:**

**Ilir Izmaku, mësimitdhënës i edukatës fizike në SHMU-1, për rezultate të mira me nxënës në nivel vendi, dhe për performancë të mirë në si futbollist aktiv në Superligën e Kosovës.**

**Lirie Ferizi, zyrtare për arsimin e mesëm të ulët, për rezultate të dëshmuara në fushën e arsimit.**

**Agron Gërxhaliu, nxënës maturant në Gjimnazin "Eqrem Çabej" Vushtrri, për suksese të shkëlqyeshme në shkollë.**

**Amire Hyseni, nxënëse – maturanthe në Gjimnazin "Eqrem Çabej" Vushtrri, për rezultate të dalluara në aktivitetet shkollore.**

**Skënder Kapiti, për kontributin e tij në ngritjen e Qendrës për mobilizimin dhe sistemin e vullnetarëve nga diaspora, për çlirimin e Kosovës.**

**Rexhep Gyndyz, nga Bursa – Turqi, për kontributin e tij në binjakëzimin e katër shkollave të Komunës së Vushtrrisë me shkollat simotra të Komunës Osmangazit të Bursës-Turqi.**

**NNP "Nuhi Ujkani", për sukseset e arritura në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese të materialeve për suvatim.**

**SH.P.K "Agrovin" – Ramadan Kasumi, për rezultate të dalluara në kultivimin dhe prodhimin e patates.**

**Firma: DPZ "Bunjaku" Vushtrri, pronari Edis Bunjaku, për të arritura në veprimtarinë: metalgdhendës, dhe për ofrimin e mundësisë për zhvillimin e praktikës së nxënësve SHMT "Lutfi Musiqi".**

**Nesim Ispahiu, për kontributin e tij në fushën e artit.**

**Fazli Rashica, për kontributin e tij afirmativ në lëmin e muzikës.**

**Klubi i basketbollit "Vushtrria Basket" për të arriturat e dëshmuara në basketboll.**

*Nimon Ferizi, (post mortum) për aktivitetin e dalluar për çështje kombëtare, pjesëmarrës në Demonstratat e vitit 1981, i përjashtuar nga procesi mësimor nga regjimi pushtues serb në v. 1981, si dhe pjesëtar i UÇK-së.*

*Jahja (Rrahim) Mehmeti- për kontributin e tij si ushtar i dalluar i UÇK-së, dhe i plagosur në luftë.*

*Sebahate Braha, ish-punëtore e Administratës komunale- për rezultate të dalluara në punë, në këtë sektor.*

*Mexhit (Hashim) Bunjaku, bashkatdhetar yni nga Norvegjia- për kontribut në ofrimin e donacioneve prej 3 autobusëve për SHMT "Lutfi Musiqi".*

*Hysen Hyseni- veteran i UÇK-së.*

*Bahri Bivolaku, si punëtor i dalluar shumëvjeçar.*

*Sevëme Fetiçi, për kontributin e saj në letërsi.*

*Vehbi Haxha, për kontributin në luftë.*

*Xhevat Deliu, i burgosur politik.*

*Behram Muharremi, i përndjekur politik.*

*Kujtim Hoti, veprimtar i dalluar, i përndjekur nga regjimi okupator (mirënjohje).*

*Haki Mikullofci, ish-punëtor i administratës.*

*Bahire Dërguti, veterane e arsimit.*

*Fahredin Gynler, biznesmen i njohur dhe kontribuues i çështjes kombëtare shqiptare.*

*Remzi Klinaku, (post-mortum), veteran i UÇK-së.*

*KF "LLAMKOS KOSOVA".*

*Ismet Munishi, trajner i KF "Llamkos Kosova".*

*Klubit të tifozëve "FORCA".*

*Myrvete Pantina, si veprimtare e dalluar.*

*Gjylsime Feka, si veprimtare e dalluar.*

*Behar Dushi, për kontributin e tij në ndihmë për sigurimin e ujit për shkollat e komunës.*

*Blerim Feka, për ndihmën e ofruar për Shoqatën e Martirëve.*

*Zehra Maxhuni, veterane e arsimit.*

**5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet dhe parandalimet e ndërtimeve pa leje ndërtimore, si dhe masat e ndërmarra për pranimet teknike të objekteve shumëkatëshe në Komunën e Vushtrrisë.**

**6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë.**

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar informatës në fjalë, i sugjeroi qeverisë lokale për të punësuar më shumë pylltarë, pasi që e ardhmja e këtij shteti është ruajtja e pasurisë natyrore, duke kërkuar që të mos punësojnë punëtorë të panevojshëm në Administratën komunale.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - lidhur me informatën në fjalë, pyeti se a është e paraparë që të pyllëzohet ndonjë pjesë e territorit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe kërkoj që të informohet se cilat pjesë janë pyllëzuar deri më tani, dhe sa hektarë janë pyllëzuar.

**Sabit Mehmeti, zyrtar i DEBPZHR-së** - paraqiti sqarime shtesë lidhur me informatën në fjalë, si dhe për pyetjet e parashtruara për këtë informatë, duke shtuar se janë të planifikuara të pyllëzohen 30 hektarë në pjesën e zhveshur të fshatit Studime.

**7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore të komunës (Drejtoria për Buxhet dhe Financa).**

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-** paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit** - rikujtoi se në vitin 2012 kuvendi i komunës ka marrë vendim për të marrë pjesë në një festival ansambli i këngëve dhe valleve "Hasan Prishtina" dhe shoqata "Çeshme" në Turqi, ku edhe e morëm vendin e tretë, edhe pse akoma shpenzimet nuk janë paguar, prandaj kërkoi që të njëjtat shpenzime të paguhen përmes ridestinimit.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se me ribalanc duhet të merret parasysh fakti që në fshatin Pasomë lagjja "Ferizi" është e pakalueshme, prandaj kërkoi që të investohet në këtë lagje për ta bërë të kalueshme rrugën në fjalë. Po ashtu e njëjta gjendje për të cilën duhet të kihet në konsideratë është një pjesë e rrugës në fshatin Sfaracak i Epërm, sikurse edhe në fshatin Banjskë, ku mungon edhe ura. Pastaj kërkoi që me ribalanc të shqyrtohet mundësia për realizimin e një projekti që ka qenë i planifikuar në fshatin Studime e Poshtme. Gjithashtu përmendi një kërkesë të kahershme të banorëve të lagjes së Rrzhaneve në Vilanc, për të cilën kërkoi që të realizohet. Në fund tha se rruga "Mujo Ulqinaku" në Vushtrri është në gjendje të rëndë, prandaj është mirë që drejtoritë kompetente të bëjnë incizimin e rrugëve në fjalë, dhe të njëjtat rrugë të rikonstruohen.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

*Me këtë vendim bëhet ridestini i mjeteve nga fondi burimor 10, nga Kategoria e investimeve kapitale, programi 664250, Planifikimi Urban dhe Mjedis dhe programi 644180 Shërbime Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjencia, nga këto programe:*

*Kodi i projektit 690249 - asfaltimi i rrugës Kollë, në vlerë 67,500.00€, shuma e mbetur e mjeteve të lira buxhetore 11,103.50€;*

*Kodi i projektit 90251 - asfaltimi i rrugës Bukosh-Brusnik, në vlerë 40,869.00€, shuma e mjeteve të lira buxhetore 2,707.50€;*

*Nga projektet e cekura në nënparagrafët: 1.1.1, 1.1.2 të këtij vendimi, ridestinohen mjetet në shumën prej 13,811.00 €, në të njëjtin program buxhetor për realizimin e projektit <Asfaltimi i rrugës hyrje-dalje te komuna>, kodi 90252, shuma ..... 13,811.00€.*

*Kodi i projektit 90225 Bashkëfinancimi me donatorë në vlerë 100,000.00€, shuma e mjeteve prej 30,000.00 € ridestinohen në të njëjtin program buxhetor në këto projekte:*

*Ndërtimi i Palestrës Sportive në Samadrexhë, shuma 20,000.00 €;*

*Renovimi i shkollës fillore "Ali Kelmendi", shuma 4,000.00 €;*

*Renovimi i shkollës fillore "Mustafë Venhari" shuma 6,000.00 €.*

**8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e vendimit të Kuvendit të komunës 01.Nr.23/14 i datës 30.01.2014.**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

*Me këtë vendim ndryshohet vendimi i Kuvendit të Komunës për emërim të anëtarëve të Komitetit për Komunitete 01Nr.23/14, dt. 30.01.2014 si në vijim: në nenin 1 pika 3, në vend të Enver Dubovci, duhet të jetë Berat Maxhuni.*

**9. Shqyrtimi i draft-rregulloreve:**

a) Për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat fillore të Komunës së Vushtrrisë.

b) Për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat e mesme të ulëta të Komunës së Vushtrrisë.

c) Për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

*Jepen për diskutim publik Draft-rregulloret për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta.*

*Diskutimi publik fillon nga data 29.05.2014 dhe zgjat deri më 17.06.2014.*

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit** - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, kërkoi që për hapësirën ku do të vendosen kiosqet, përballë Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina" t'ju jepet përparësi në dhënien në shfrytëzim zejtarëve që kanë punuar në hapësirën në fjalë me vite të tëra (prej 30-40 vite).

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** - tha se përkundër respektit të zejtarëve që kanë punuar për shumë vite në kiosqet në fjalë, para ligjit janë të barabartë të gjithë të interesuarit (aplikuesit).

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota "për", të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

*Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronave të paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, të cilat gjenden në këto lokacione:*

*Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Adem Jashari", ngastra kadastrale nr.P-653, zona kadastrale Vushtrri, pronë e komunës, e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 182 m<sup>2</sup> dhe e cila është e propozuar të ndahet në katërmbëdhjetë hapësira me nga 13 m<sup>2</sup>;*

*Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Tirana", ngastra kadastrale nr.P-256, zona kadastrale Vushtrri, pronë e komunës, e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 36 m<sup>2</sup> dhe e cila është e propozuar të ndahet në katër hapësira me nga 9m<sup>2</sup>;*

*Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Kruja", ngastra kadastrale nr.P-1102, zona kadastrale Vushtrri, pronë e komunës, e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 51 m<sup>2</sup> dhe e cila është e propozuar të ndahet në pesë hapësira, tri me nga 9m<sup>2</sup> dhe dy me nga 12m<sup>2</sup>;*

*Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Dëshmorët e Kombit", ngastra kadastrale nr. P-1116 dhe P-494/1 zona kadastrale Vushtrri, prona të komunës, të cilat përfshijnë një sipërfaqe ndërtuese prej 64 m<sup>2</sup> dhe e cila është e propozuar të ndahet në dy hapësira me nga 32m<sup>2</sup>;*

*Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Xhon Buzuku", ngastra kadastrale nr. P-420/2 zona kadastrale Vushtrri, pronë e komunës, e cila përfshin një sipërfaqe prej 47 m<sup>2</sup> dhe e cila është e propozuar të ndahet në tri hapësira, një me 9m<sup>2</sup>, një me 12m<sup>2</sup> dhe një me 26m<sup>2</sup>;*

*Lokacioni i cili gjendet me lokalet në rrugën "Jeton Tërrstena", ngastra kadastrale nr. P-2254/49, zona kadastrale Vushtrri, prona të komunës, të cilat përfshijnë një sipërfaqe prej 133 m<sup>2</sup> dhe për të cilat është propozuar të jepen sipas skicës:*

*\*Lokali nr.1 me sipërfaqe prej 16m<sup>2</sup>,*

*\* Lokali nr.2 me sipërfaqe prej 12m<sup>2</sup>,*

*\* Lokali nr.3 me sipërfaqe prej 11m<sup>2</sup>,*

*\* Lokali nr.5 me sipërfaqe prej 11m<sup>2</sup>,*

*\* Lokali nr.7 me sipërfaqe prej 21m<sup>2</sup>,*

*\* Lokali nr.8 me sipërfaqe prej 62m<sup>2</sup>*

### **11. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien e ndihmës financiare për shërim.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

*Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës - Fondi për subvencione, për Belxhyzare Maxhunin, me banim në Vushtrri, në shumën prej 2.500 € (dy mijë e pesëqind euro).*

### **12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve.**

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, paraqiti shqetësimin për mosfunksionimin e kujdestarisë së barnatoreve, pasi që është nevojë e domosdoshme të ketë kujdestari prej tyre. Pastaj duke iu referuar nenit 15.1, tha se ordinancat private mund të punojnë edhe me gjysmë orari të punës, prandaj nuk është e obligueshme të punojnë prej orës 07:00 – 23:00 ordinancat, laboratorët dhe rëntgenët. Në fund tha se për zbatimin e këtij vendimi është dashtë të jetë përgjegjëse edhe Drejtoria për Inspektive.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

*Jepet për diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve.*

*Diskutimi publik fillon nga data 29.05.2014 dhe zgjat deri më 17.06.2014.*

### **13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga Fondi për transfere dhe subvencione.**

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, propozoi që t'i ndahet shuma prej 1.000 € tifozërisë “Forca”, për ta shënuar sa më mirë festën e fitores në të dielën.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - kërkoi nga drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, që tre punëtorët teknik të klubit futbollistik të futen në listën e pagave në kuadër të drejtorisë në fjalë, pasi që të njëjtit paguhen nga klubi.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

*Me këtë vendim, mjetet buxhetore të komunës - Fondi për transfere dhe subvencione, për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive për vitin 2014, nga vlera totale prej 29,375.00 €, ndahet:*

*a. Shuma prej 2,500.00 € (dy mijë e pesëqind euro) për subvencionim të lojtarëve të Klubit të futbollit “Llamkos”;*

*b. Shuma prej 1,000.00 € (një mijë euro) për Klubin e tifozëve “FORCA”.*

### **14. Të ndryshme:**

#### **a. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë shëndetësore për shërim.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

*Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës - Fondi për subvencione, për Ismet Ramën, me banim në fshatin Stanoc i Poshtëm, Komuna Vushtrri, në shumën prej 600 € (gjashtëqind euro).*

**b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota "për", të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

*Me këtë vendim aprohet Plani Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë, për periudhën 2014-2019, i cili ka për qëllim krijimin e bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile, publikut, pushtetit lokal dhe qendror.*

**c. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të lagjes të kompleksit banesor "Kalaja".**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

*Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 28.05.2014 ka shqyrtuar kërkesën e banorëve të kompleksit banesor "KALAJA", e cila gjendet në rrugën "Dëshmorët e Kombit" në Vushtri, të përfaqësuar nga z. Ilmi Beqiri, prandaj ju informojmë se Komuna e Vushtrrisë nuk pengon shitblerjen e banesave që janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në objektin në fjalë.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:52.

Procesmbajtësi



Alban Tahiraj

Lekturoi

Vlora Krasniqi

